

курс за доделување на средствата за давање социјални услуги од страна на здруженија, согласно со Законот за социјалната заштита („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 104/19 и 146/19).

Член 38

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 39

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Северна Македонија да утврди пречистен текст на Законот за социјалната заштита.

Член 40

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE SOCIALE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje sociale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19 dhe 146/19), në nenin 30 në paragrafin 2 pas fjalëve: “ekonomi familjare” vihet pikë dhe fjala “materiale” shlyhet.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

“Qendra për Punë Sociale me detyrë zyrtare e kontrollon gjendjen materiale të bartësit të të drejtës së garantuar të ndihmës minimale dhe me të gjithë anëtarët e familjes me moshë madhore, nëpërmjet sigurimit të të dhënave për të hyrat e realizuara mujore nga evidenca zyrtare e organit kompetent publik, Ministria e Financave – Drejtoria e të Hyrave Publike.”

Neni 2

Në nenin 40 paragrafin 1 në alinenë 2 pas fjalëve: “ekonomi familjare” presja dhe fjala “materiale” shlyhen.

Neni 3

Në nenin 76 pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, asistenca personale mund të përfshijë 80 orë plotësuese në muaj për person që nga përkujdesja rezidenciale kalon në banim në objekt banesor ose me përkrahje, ndërsa për shkak të nevojës më të madhe nga ndihma dhe përkrahja për jetesë të pavarur dhe të mëvetësishme dhe përfshirje në bashkësi.”

Paragrafi 3 bëhet paragraf 4.

Neni 4

Në nenin 100 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, gruaja e papunë vetushqyese shtatzënë një muaj para lindjes dhe prindi vetushqyës deri në moshë tre vjeçare të fëmijës, mund të vendoset edhe në institucion për fëmijë.”

Neni 5

Në nenin 111 në paragrafin 1 fjalët: “Enti për Veprimtari Sociale”, zëvendësohen me fjalët: “Komisioni për Miratimin e Programeve për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, dorëzon raport për volitshmëritë e familjes kujdestare në Qendrën e Punëve Sociale.”.

Neni 6

Në nenin 126 paragrafi 2 ndryshohet si vijon: “Kriteret e përafërta për zgjedhjen e familjes kujdestare, llojin dhe numrin e shfrytëzuesve të cilët mund të vendosen një familje kujdestare” standardet për dhënen e shërbimit përkujdesje, normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë së qendrës për përkrahjen e familjeve kujdestare dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës dhe dokumentacionit për familjet kujdestare i përcakton ministri.”.

Neni 7

Në nenin 128 paragrafi 2 ndryshohet si vijon: “Shoqata, shërbimet sociale në shtëpi, shërbimet sociale në bashkësi dhe shërbimi prej mbrojtjes jashtë familjes dhe atë jetesë me përkrahje, i jep pa themelim të institucionit, në pajtim me statutin dhe programin e punës së shoqatës.”.

Neni 8

Në nenin 178 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Në rast të ndryshimit të themeluesit të institucionit privat për mbrojtje sociale jashtë familjes nga paragrafi 1 i këtij neni, pas kërkesës së dorëzuar të themeluesit, me mendim të Komisionit për Licencimin e Dhënësve të Shërbimeve Sociale nga neni 166 të këtij ligji, ministri miraton vendim për ndryshimin e themeluesit.”.

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Neni 9

Në nenin 236 paragrafin 2 alinenë 1 lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalës “psikologjike” shtohen fjalët: “dhe të defektologjisë”.

Në paragrafin 3 fjalët: “alinetë 1 dhe 3” zëvendësohen me fjalët: “alinetë” 1, 2 dhe 3”.

Neni 10

Në nenin 238 në paragrafin 2 pas fjalëve: “mbrojtje vihet pikë dhe shtohen fjalët: “vetëm nëse nuk është i zbatuar edukimi fillestar dhe i vazhdueshëm për lëshimin e licencave për kryerjen e punës profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale, në pajtim me ligjin.”.

Neni 11

Në nenin 242 fjalët: “dhe e jep provimin profesional” shlyhen.

Neni 12

Në nenin 244 në paragrafin 1 fjalët: “dhe përtëritje” shlyhen.

Neni 13

Në nenin 249 në paragrafin 2 pas fjalës “komuna” vihet presje dhe shtohen fjalët: “përkatësisht për punëtorët profesionistë të dhënësit tjerë të shërbimeve sociale nga dhënësi i shërbimit”.

Neni 14

Në nenin 281 në paragrafin 4 fjalët: “dhe lista e shfrytëzuesve” shlyhen.

Neni 15

Në nenin 284 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj si vijojnë:

“Ministria mund të japë vërtetim ose certifikatë nga paragrafi 1 i këtij neni si dokument elektronik nga sistemi i evidencës për të dhënat e mbrojtjes sociale me të cilin menaxhon, të konfirmuar me vulë elektronike, në pajtim me Ligjin për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime të besueshme dhe Ligjin për menaxhim elektronik dhe shërbime elektronike.

Vërtetimi ose certifikata e lëshuar në mënyrë të përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni kanë fuqinë e njëjtë juridike dhe dëshmuese si forma e tyre me shkrim.”

Neni 16

Në nenin 295 në paragrafin 3 fjala “procedurë” shlyhet.

Neni 17

Në nenin 324 fjalët: “dhe nëpunës tjerë shtetërorë në Ministri, të autorizuar për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese” zëvendësohen me fjalët: “nga shërbimi inspektues në Ministri me licencë të fituar për inspektor”.

Neni 18

Neni 325 ndryshohet si vijon:

“Inspektor mund të jetë personi i cili i plotëson kushtet e veçanta në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë dhe Ligjin për mbikëqyrje inspektuese.”.

Neni 19

Në nenin 326 pas fjalës “ligji” shtohen fjalët: “dhe Ligjit për mbikëqyrje inspektuese”.

Neni 20

Në nenin 327 në paragrafin 2 fjala “Ministri” zëvendësohet me fjalët: “Këshilli Inspektues”.

Neni 21

Neni 330 ndryshohet si vijon:

“Udhëheqësi i shërbimit inspektues përpilon plan vjetor të punës për punën e shërbimit inspektues më së voni deri në fund të vitit rrjedhës, për vitin paraprak, që publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

Plani vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni, më së voni deri më 15 nëntor në vitin rrjedhës dorëzohet në Këshillin Inspektues, në formë elektronike dhe në letër.”.

Neni 22

Në nenin 334 në paragrafin 2 fjalët: “edhe Kodi etik i shërbimit inspektues” shlyhen.

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“Personi udhëheqës ose person tjetër i autorizuar në institucionin për mbrojtje sociale, në institucionin për mbrojtjen e fëmijëve dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë punë të mbrojtjes sociale, janë të obliguar menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tri ditëve pas kalimit të afatit të përcaktuar për kryerjen e masës inspektuese, me shkrim ta informojnë inspektorin nëse janë zbatuar masat inspektuese.”

Neni 23

Neni 335 ndryshohet si vijon:

“Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, gjendjen dhe parregullsitë e konstatuara, Inspektori përpilon procesverbal.”

Neni 24

Neni 336 ndryshohet si vijon:

“Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese inspektori i autorizuar konstaton se është kryer parregullsi nga neni 350, 350-a, 350-b, 351, 352, 353 dhe 354 të këtij ligji, inspektori i autorizuar me aktvendim shqipton vërejtje dhe e përcakton afatin në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuara në procesverbal.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në rast kur inspektori do të vlerësojë që parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara mund të shkaktojnë ose shkaktojnë rrezik të menjëhershëm për jetën dhe shëndetin e njerëzve ose dëm financiar ose dëm të pronës me vlerë më të madhe ose rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese, siç është ngarkimi, urdhëresa, ndalimi dhe masë tjetër, me të cilën do të arrihet në mënyrë përkatëse qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

Nëse pas skadimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori përcakton se parregullsitë dhe mangësitë nuk janë mënjanuar ende, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese, siç është ngarkimi, urdhëresa, ndalimi dhe masë tjetër, me të cilën do të arrihet në mënyrë përkatëse qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

Aktvendimi nga paragrafët 1, 2 dhe 3 i këtij neni miratohet menjëherë dhe më së voni brenda tetë ditëve nga dita e përgatitjes së procesverbalit.

Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelke tjera të ligjit ose rregullës tjetër, ose parregullsitë e konstatuara janë mënjanuar gjatë inspektimit ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal.

Me përjashtim nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me vendim gojor të shënuar në procesverbal.

Në rastin në paragrafin 6 të këtij neni, inspektori është i detyruar, menjëherë e më së voni në afat të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese.

Forma dhe përmbajtja e aktvendimit nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, me propozimin e Këshillit Inspektues, përcaktohet nga Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Për kundërvajtje për një ose më shumë punëtorë profesionistë të cilët drejtpërdrejt i kryejnë punët dhe subjektet e mbikëqyrjes do të shqiptohet vërejtje nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë.

Ministri i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës të vërejtjeve të shqiptuara.”

Neni 25

Neni 337 ndryshohet si vijon:

“Udhëheqësi i shërbimit inspektues për punën e shërbimit inspektues përgatit raport për gjashtë muajt paraprakë, më së voni deri 15 korrik për periudhën janar -

qershor të vitit rrjedhës, përkatësisht më së voni deri 15 janar për periudhën korrik - dhjetor të vitit paraprak, që publikohet në faqen e internetit të shërbimit inspektues.

Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni, mbi punën e shërbimit inspektues, më së voni deri më 31 korrik përkatësisht 31 janar i paraqitet Këshillit Inspektues, në formë elektronike dhe në letër."

Neni 26

Neni 350 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në vlerë prej 800 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje institucionit për mbrojtje sociale ose personit tjetër juridik, nëse:

- shfrytëzuesin e mbrojtjes sociale e vendos në pozitë të pabarabartë (neni 16 i këtij ligji),

- nuk e njofton për ndërprerjen e punës së institucionit privat (neni 180 i këtij ligji),

- nuk ofron mbrojtje sociale të personit në pozitë të rrezikut social (neni 115 paragrafi 1, alineja 2 të këtij ligji),

- nuk mban ose në mënyrë të parregullt e mban evidencën e përcaktuar (neni 254 paragrafi 1 të këtij ligji),

- nuk i zbaton masat e përcaktuara në nenin 315 paragrafin 4 të këtij ligji,

- nuk e respekton ndalimin për zbatimin e masave dhe ndërmarrjen e punëve që janë në kundërshtim me Ligjin dhe dispozita tjera, gjatë kryerjes së punëve nga mbrojtja sociale (neni 339 paragrafi 1 alineja 1 e këtij ligji),

- nuk e respekton ndalimin për punë të institucionit të mbrojtjes sociale dhe të ndonjë personi tjetër juridik ose fizik i cili kryen veprimtari të caktuara të mbrojtjes sociale dhe nuk ndërmerr masa të tjera (neni 342 paragrafi 1, pikat 1 dhe 2) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 200 deri në 500 euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në institucionin e mbrojtjes sociale ose në person tjetër juridik.

Gjobë në shumë prej 150 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni punëtorit i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i kryen punët.

Gjobë në shumë prej 150 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe udhëheqësit të seksionit në institucionin e mbrojtjes sociale."

Neni 27

Pas nenit 350 shtohen dy nene të reja 350-a dhe 350-b, si vijojnë:

„Neni 350-a

"Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në institucionin për mbrojtje sociale ose person tjetër juridik, nëse:

- nuk vepron sipas vendimit për mënjanimin e mangësive dhe parregullsive të konstatuara në afatin e përcaktuar (neni 338 paragrafi 1, alineja 1 dhe 2 të këtij ligji),

- pamundëson kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes inspektuese (neni 334 paragrafi 3 të këtij ligji),

- menjëherë pas kalimit të afatit të përcaktuar për kryerjen e masës së inspektimit, kurse më së voni në afat prej tre ditëve, nuk e ka njoftuar me shkrim inspektorin nëse janë kryer masat inspektuese (neni 334 paragrafi 4 i këtij ligji),

- pamundëson kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën profesionale (neni 347 të këtij ligji),

- në afatin e përcaktuar nuk ndërmerr masa për mënjanimin e mangësive të përcaktuara nga mbikëqyrja e kryer mbi punën profesionale (neni 348 të këtij ligji), dhe

- nuk vepron sipas njoftimit për marrjen e licencës për punë të punëtorit profesional (neni 243 paragrafi 3 të këtij ligji).

Gjobë në shumë prej 70 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar nga qendra e cila e mban procedurën, nëse:

- nuk miraton vendim në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 282 të këtij ligji).

- nuk mban ose në mënyrë të parregullt e mban dokumentacionin e përcaktuar (neni 254 paragrafi 1 i këtij ligji),

- pamundëson kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes inspektuese (neni 334 paragrafi 3 të këtij ligji) dhe

- pamundëson kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën profesionale (neni 347 të këtij ligji).

Neni 350-b

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar, nëse sipas detyrës zyrtare nuk kërkon dëshmi dhe të dhëna për të cilën evidencë zyrtare mban organi kompetent publik, në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të kërkesës (neni 268 i këtij ligji).

Gjobë në vlerë prej 150 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik i cili kryen punë të caktuara nga mbrojtja sociale, nëse:

- nuk e respekton ndalimin për zbatimin e masave dhe ndërmarrjen e punëve që janë në kundërshtim me Ligjin dhe dispozita tjera, gjatë kryerjes së punëve nga mbrojtja sociale (neni 339 paragrafi 1 alineja 1 e këtij ligji),

- nëse nuk mban evidencë të shfrytëzuesve të shërbimeve të dhëna (neni 133 paragrafi 1 alineja 3 e këtij ligji) dhe

- nuk njofton për ndërprerjen e përkohshme për kryerjen e punëve (neni 138 paragrafi 2 të këtij ligji)."

Neni 28

Në nenin 351 fjalët: "prej 1.000 deri 2.000" zëvendësohen me fjalët: "prej 300 deri 500".

Neni 29

Në nenin 352 paragrafin 1 fjalët: "prej 1.000 deri 2.000" zëvendësohen me fjalët: "prej 300 deri 500".

Në paragrafin 2 fjalët: "prej 1.000 deri 2.000" zëvendësohen me fjalët: "prej 300 deri 500".

Neni 30

Neni 353 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në institucionin për mbrojtje sociale ose person tjetër juridik, nëse:

- nuk paraqet raport (neni 115 paragrafi 1 alineja 10 të këtij ligji), dhe

- nuk e harmonizon orarin, fillimin dhe mbarimin e orarit të punës (neni 253 të këtij ligji).

Gjobë në shumë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit i cili kryen punë të caktuara në mbrojtje sociale."

Neni 31

Në nenin 354 numri "2.000" zëvendësohet me fjalët: "prej 800 deri 1.000".

Neni 32

Neni 356 ndryshohet dhe vijon:

"Për kundërvajtjet nga nenet 350, 350-a, 350-b, 351, 352, 353 dhe 354 të këtij ligji, inspektori kompetent, para se të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse, personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij, do t'i ofrojë procedurë për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse në pajtim me ligjin për kundërvajtje.

Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet me procedurën për barazim, inspektori përpilon procesverbal dhe i lëshon urdhërpagesë kundërvajtëse personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij.

Procesverbalin dhe urdhërpagesën e nënshkruan inspektori dhe kryerësi i kundërvajtjes. Pas pranimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar të paguajë gjobën e shqiptuar në urdhërpagesën kundërvajtëse në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të urdhërpagesës kundërvajtëse.

Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës ose personi i autorizuar prej tij.

Kryesi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar për të drejtën e së cilës këshillohet në këshillën juridike.

Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse te organi kompetent.

Në procedurën për barazim gjoba në urdhërpagesë kundërvajtëse shqiptohet në shumë fikse të përcaktuar me ligj, kurse nëse gjoba është e përcaktuar në distancë, shqiptohet shuma minimale e përcaktuar për kundërvajtjen.

Në procedurën e cila do të mbarojë me pagimin e urdhërpagesës kundërvajtëse nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

Nëse kryerësi nuk pajtohet t'i lëshohet urdhërpagesë kundërvajtëse e njëjta do të shënohet në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar, kurse inspektori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente."

Neni 33

Neni 357 ndryshohet si vijon:

"Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale."

Neni 34

Institucionet dhe personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale, do ta harmonizojnë punën e tyre, aktet e tyre dhe përbërjen e organeve të menaxhimit me dispozitat e këtij ligji në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 35

Personat profesionistë dhënë të shërbimeve publike, të punësuar në institucione publike dhe private të mbrojtjes sociale dhe te dhënë tjerë të shërbimeve sociale që nuk

kanë marrë licencë për kryerjen e punës profesionale në fushën e mbrojtjes sociale, respektivisht nuk e kanë rinovuar ose vazhduar licencën, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të punojnë në institucionet e mbrojtjes sociale si dhe te dhënë tjerë të shërbimeve sociale, deri në marrjen e licencës në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Personat nga paragrafi 1 të këtij neni janë të detyruar të marrin licencë për kryerjen e punës profesionale në fushën e mbrojtjes sociale, në procedurë të përcaktuar në përputhje me këtë ligj, në afat prej gjashtë muajve nga dita e vendosjes së regjistrimit elektronik të programeve të miratuara për edukim profesional dhe zbatim i provimit profesional për marrjen e licencës për kryerjen e punës profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale.

Instituti për Veprimtari Sociale zbaton edukim në përputhje me Programin për edukim profesional të vazhdueshëm për punëtorët profesionistë nga paragrafi 1 i këtij neni, deri në vendosjen e regjistrimit elektronik të programeve të miratuara.

Personave nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët nuk marrin licencë për kryerjen e punëve profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale, në afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, u pushon marrëdhënia e punës.

Neni 36

Komisioni për Licencim të Dhënësve të Shërbimeve Sociale dhe Komisioni për Sigurimin e Mjeteve, do të formohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në krijimin e regjistrimit elektronik të programeve të miratuara të edukimit profesional dhe zbatimit e procedurës për edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për marrjen e licencës për kryerjen e punëve profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale, në pajtim me këtë ligj, shërbimet e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi dhe asistencë personale do të ofrohen drejtpërdrejt nga persona me certifikatë për trajnim të mbaruar për aftësi të fituara, të verifikuara nga IP Qendra për Arsimit të të Rriturve.

Neni 37

Shoqata e cila do të ofrojë shërbime të mbrojtjes sociale do ta harmonizojë statutin dhe programin për punë nga nenin 7 i këtij ligji me të cilin ndryshohet paragrafi 2 i nenit 128 të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " numër 104/19 dhe 146/19), në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Deri në vendosjen e evidencës për ofrues të licencuar të shërbimeve sociale, mjetet për dhënie të shërbimeve sociale mund t'i ndahen shoqatës e cila është regjistruar në Regjistrin e Shoqatave në Fushën e Mbrojtjes Sociale, pas konkursit publik për ndarjen e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale nga shoqatat, në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19 dhe 146/19).

Neni 38

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 39

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtje sociale.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

4299.

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за пензиското и инвалидското осигурување,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 27 декември 2019 година.

Бр. 08-7146/1
27 декември 2019 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Стево Пендаровски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi**, с.р.

ЗАКОН

ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ

Член 1

Во Законот за пензиското и инвалидското осигурување („Службен весник на Република Македонија” број 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 и 245/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија” број 180/19), во член 37 по ставот (3) се додаваат два нови става (4) и (5), кои гласат:

„(4) Во случај кога има пораст на минималната плата во тековната година за повеќе од 15% и пораст на просечна плата во претходната година за повеќе од 5%, покрај усогласувањата наведени во ставовите (1) и (3) на овој член, може да се изврши дополнително усогласување на пензиите во процент не повисок од порастот на просечната плата во претходната година.

(5) Висината и начинот на дополнителното усогласување на пензиите од ставот (4) на овој член со одлука ги определува Владата на Република Северна Македонија.”.

Член 2

Во член 221 став (1) зборовите: „3.000 евра“ се заменуваат со зборовите: „1.000 до 2.000 евра“.

Во став (2) зборовите: „300 до 400 евра“ се заменуваат со зборовите: „100 до 200 евра“.

Во став (3) зборовите: „3.000 евра во денарска противвредност“ се заменуваат со зборовите: „200 до 500 евра во денарска противвредност за микро трговци, од 500 до 700 евра во денарска противвредност за мали трговци, од 700 до 1.000 евра во денарска противвредност за средни трговци и од 1.000 до 2.000 евра во денарска противвредност за големи трговци“.

Во став (4) зборовите: „300 до 400 евра“ се заменуваат со зборовите: „150 до 250 евра“.

Во став (5) зборовите: „3.000 евра во денарска противвредност“ се заменуваат со зборовите: „100 до 200 евра во денарска противвредност за микро трговци, од 200 до 400 евра во денарска противвредност за мали трговци, од 400 до 600 евра во денарска противвредност за средни трговци и од 600 до 800 евра во денарска противвредност за големи трговци“.

Во став (6) зборовите: „30% од одмерената глоба за правното лице од ставот (3) на овој член“ се заменуваат со зборовите: „300 до 500 евра во денарска противвредност“.

Во став (7) зборовите: „300 до 400 евра“ се заменуваат со зборовите: „150 до 250 евра“.

Во став (8) зборовите: „300 до 400 евра“ се заменуваат со зборовите: „200 до 300 евра“.

Член 3

Во член 223 став (1) зборовите: „300 до 400 евра“ се заменуваат со зборовите: „200 до 300 евра“.

Член 4

Одредбите од членот 187 став (1) точка 7 од Законот за пензиското и инвалидското осигурување ќе се применуваат со започнувањето на примената на Законот за акцизите* („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 108/19, 143/19 и 225/19).

Член 5

Овој закон влегува во сила со денот на објавување то во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 180/19), në nenin 37 pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

“(4) Në rast kur ka rritje të rrogës minimale në vitin rrjedhës për më shumë se 15% dhe rritje të rrogës mesatare në vitin paraprak për më shumë se 5%, krahas